



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04

Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës

Vendosi: Trupi Gjykses I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, Kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 4 prill 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Urdhër për Parashtrime në lidhje me Heqjen e Redaktimeve dhe/ose
Riklasifikimin e Transkripteve të Seancave Gjyqësore**

**Ushtruesit të Detyrës së Prokurorit të
Specializuar**
Aleks Uajting

Mbrojtjes së të Akuzuarit
Zhan-Lui Zhilisen

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

TRUPI GJYKUES I (Trupi Gjykues) lëshon këtë urdhër për parashtrime në lidhje me heqjen e redaktimeve dhe/ose riklasifikimin e transkripteve të seancave gjyqësore.

1. Më 27 mars 2023 filloi paraqitja e provave në këtë çështje gjyqësore dhe mes 27 dhe 30 marsit 2023, Trupi Gjykues dëgjoi dëshmitë e dëshmitarëve TW4-06, TW4-07, TW4-08 dhe TW4-09.¹
2. Trupi Gjykues mbështetet në nenet 21(2), 23 dhe 40(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji) dhe rregullat 80 dhe 84(1) Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (Rregullorja).
3. Trupi Gjykues rikujton se, në pajtim me nenin 21(2) të Ligjit dhe masat mbrojtëse për dëshmitarët dhe viktimat të miratuara sipas nenit 23 të Ligjit, në shqyrtimin e akuzave kundër tij, i akuzuari gëzon të drejtën për gjykim publik.
4. Me qëllim që të respektohet parimi i publicitetit, duke respektuar në të njëjtën kohë masat mbrojtëse për dëshmitarët dhe viktimat, Trupi Gjykues e çmon të përshtatshme të urdhërojë palët dhe Mbrojtësin e Viktimave të bëjnë rishikimin e transkripteve të seancave gjyqësore që janë zhvilluar nga 27 deri më 30 mars 2023 dhe të paraqesin parashtrime nëse mund të hiqen redaktimet dhe/ose transkriptet të riklasifikohen si publike.
5. Palët dhe Mbrojtësi i Viktimave duhet të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për të dorëzuar parashtrime të përbashkëta përmes një parashtrimi përmbledhës për heqjen e redaktimeve/riklasifikimin e transkripteve. Palët dhe Mbrojtësi i

¹ KSC-BC-2020-04, Transkripti i seancës, 27 mars 2023, konfidencial; Transkripti i seancës, 28 mars 2023, konfidencial; Transkripti i seancës, 29 mars 2023, konfidencial; Transkripti i seancës, 30 mars 2023, konfidencial.

Viktimave duhet të garantojnë që, parashtrimet e tyre për heqjen e redaktimeve/riklasifikimin e transkripteve të jenë përputhëse në lidhje me përmbajtjen e cilitdo transkript dhe të gjitha transkripteve përkatëse.

6. Në rast se palët dhe mbrojtësi i viktimave nuk pajtohen për pjesë të ndonjë transkripti, atëherë duhet ta specifikojnë këtë në parashtrimet e tyre, së bashku me arsyet për mopajtimin. Në fund, Trupi Gjykes vendos në lidhje me heqjen e redaktimeve dhe/ose riklasifikimin e transkripteve në pajtim me rregullat 80(1) dhe 84(1) të Rregullores.

7. Për arsyet e përmendura në lart, Trupi Gjykes:

URDHËRON palët dhe Mbrojtësin e Viktimave të dorëzojnë parashtrimet, siç specifikohet më lart, brenda **të premtes, 14 prill 2023, në orën 12:00.**

/nënshkrimi/

Gjykatëse Mapi Feld-Folia
Kryegjykatëse

/nënshkrimi/

Gjykatës Zhilber Biti

/nënshkrimi/

Gjykatës Roland Dekers

E martë, 4 prill 2023

Në Hagë, Holandë.